



## Numri Global i Artikullit Tregtar (GTIN)

Numri Global i Artikullit Tregtar (GTIN) perdoret nga kompania per te identifikuar ne menyre unike te gjithe artikujt tregtare. GS1 i perkufizon artikujt tregtare si produkte apo sherbime te cilet kane nje vlere monetare, porositen apo faturohen ne cdo stad te zinxhirit te furnizimit.

- GTIN mund te perdoret per te identifikuar llojet e produkteve ne cdo nivel te paketimit (p.sh. si njesi konsumi, pakete e brendshme, kuti, arke, palete etj.). Grupet e artikujve tregtare me karakteristika te ngjashme te prodhimit dhe te perdorimit, si partite e prodhimit, mund te identifkohen me tej me ndihmen e numrit te partise/batch-it, daten e skadimit, dhe elemente te tjere te ngjashem te te dhenave. Artikujt individuale tregtare mund te identifkohen ne menyre unike duke perdorur GTIN-in plus numrin e serise.

- Me ane te caktimit te GTIN-it ne nje artikull tregtar, kompania mundeson krijimin e nje gjuhe te perbashket per te gjithë subjektet dhe partneret e saj tregtare ne te gjithë boten, per te identifikuar ne menyre unike artikujt tregtare si dhe per te komunikuar lehtesisht informacionin lidhur me keto artikuj.


- GTIN mund te kodohet ne nje barkod ose ne nje etikete EPC/RFID. Nepermjet skanimit te barkodit apo te etiketes EPC/RFID, kompanite mund te procesojne ne menyre efikase dhe me saktesi produktet dhe informacionin e lidhur me to; p.sh., ne piken e shitjes ne dyqane, ne magazine gjate frunizmit me artikuj ose gjate administrimit te ilaceve ne nje spital.

- GTIN-et mund te perdoren per te identifikuar saktesisht artikujt tregtare qe shfaqen ne platforma dixhitale (online), p.sh. ne kataloge, ne mesazhe elektronike te tilla si urdhrat e blerjes/faturat, duke lehtesuar keshtu proceset e kerkimeve dixhitale dhe informimin e shpejte te konsumatoreve mbi keto artikujt.

GTIN ESHTË PLOTËSISHT NE PERPUHJE ME ISO/IEC15459 - PJESA 4: PRODUKTE INDIVIDUALE DHE PAKOT E PRODUKTEVE

Ekzistojne 4 formate GTIN. Per aplikimet qe kerkojne nje format uniform 14-shifror, duhet te shtohen 0 ne fillim:

- 000000nnnnnnnn (GTIN-8)
- 00nnnnnnnnnnnn (GTIN-12)
- 0nnnnnnnnnnnnn (GTIN-13)



■ Shifra e Kontrollit     ■ Fillimi i Prefiksit GS1 te Kompanise  
■ Numer                     ■ Shifra e indikatorit

<<< pozicioni i ndryshueshem i fillimit  
 >>> gjatesi e ndryshueshme